



**MITROVICA**

KOMPANIA RAJONALE UJESJELLESË SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.



KOMPANIA RAJONALE UJESJELLESË SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.  
MITROVICA  
TEL: +383 797 520-304

Nr. 01-157

Data: 18.03.19

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo  
Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja  
Ministry of Economic Development

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit: 01/3 Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.: 593

Nr. i faqeve Broj stranica No. pages: 1 Data Datum Date: 18.03.19

PRISHTINË/A

## Raporti vjetor i KRUM-së për Vitin 2018

Vendimi : (01-157)

Bordi i Drejtorëve i KRUM-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 18.03.2019, njëzërit miratoi Raportin vjetor për vitin 2018.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv (emër mbiemër) Sami Miftari	Kryesuesi i BD (emër mbiemër) Blerim Gërxhaliu
Nënshkrimi		
Data	<u>18.03.2019</u>	<u>18.03.2019</u>



**KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI**  
**“MITROVICA” Sh. A.**

**RAPORT VJETOR - 2018**

## Permbajtja

<b>HYRJE .....</b>	<b>4</b>
<b>1. RAPORTI I KRYESUSIT TE BORDIT .....</b>	<b>4</b>
1.1 AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES KRU “MITROVICA” .....	4
1.2 PASQYRA E PËRFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE .....	5
1.3 NGJARJET TE CILAT NDIKOJNE NË TË ARDHMEN E NDËRMARRJËS .....	7
<b>2. RAPORTI I KRYSHFIT EKZEKUTIV .....</b>	<b>9</b>
2.1 NGJARJET KRYSORE .....	9
2.2 PASQYRIMI I PERFORMANCËS DHE REZULTATET E INDIKATORËVE KYQ TË PERFORMANCËS .....	10
2.2.1 RAPORTI I SHËRBIMIT KOMERCIAL .....	10
<b>3. RAPORT I DEPARTAMENTIT TEKNIK .....</b>	<b>15</b>
<b>4. RAPORTI I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV .....</b>	<b>25</b>
<b>5. RAPORT MBI PROJEKTET KAPITALE .....</b>	<b>29</b>
<b>6. RAPORT I PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMI JANAR –DHJETOR 2018 .....</b>	<b>33</b>
<b>7.PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE DHE REZULTATET .....</b>	<b>49</b>
7.1 Rekapitulimi i të dhënave KRU pa Veriun .....	49
7.2 Njësia operative – Vushtrri .....	53
7.3 Njësia operative – Skenderaj .....	54
7.4 Të dhënat operativo – financiare në nivel të kompanisë KRU MITROVICA .....	55
8.1 Të hyrat dhe shpenzimet për Janar - Dhjetor 2018 .....	57
8.2 RAPORT MBI SUBVENCIONET E PRANUARA GJATË VITEVE 2018 .....	61
<b>9. RAPORT I PROKURIMIT .....</b>	<b>62</b>
<b>10. PASQYRAT FINANCIARE .....</b>	<b>65</b>
Shpalosjet dhe Notat e Pasqyrave Financiare .....	73
<b>1.3. Veprimtaria e Kompanisë.....</b>	<b>73</b>
PASURITË FIKSE .....	80
KAPITALI AKSIONAR – EKUITETI .....	83
<b>11. STRUKTURA ORGANIZATIVE.....</b>	<b>92</b>

## Lista e Tabelave

Table 1 Rritja e numrit të Konsumatorëve – krahasimi 2018/2017.....	10
Table 2 Konsumatorë e rexhistruar sipas muajve.....	11
Table 3 Performanca operative sipas njësive, kategorive dhe viteve krahasuese.....	12
Table 4 Performanca e Njësive Operative për vitet 2017 dhe 2018 – Inkasimi ndaj Faturimit.....	13
Table 5 Numri I konsumatoreve ne baze te matjes dhe pagesat sipas kategorive .....	14
Tabela 6. Rekapitulimi i të dhënave pa veriun për periudhën Janar- Dhjetor 2018 .....	49
Tabela 7. Rekapitulimi i të dhënave KRU me Veriun Janar-Dhjetor .....	50
Tabela 8. Rezultatet operativo-financiare te NJO Mitrovicë per Janar-Dhjetor .....	52
Tabela 9. Rezultatet operativo-financiare te NJO Vushtrri per Janar-Dhjetor.....	53
Tabela 10. Rezultatet operativo-financiare te NJO Skenderaj per Janar-Dhjetor.....	54
Tabela 11. Të dhënat operativo – financiare në nivel të kompanisë KRU MITROVICA për periudhën Janar-Dhjetor .....	55
Table 12 Të hyrat dhe shpenzimet sipas kategorive dhe njësive.....	57
Table 13 Distributimi, Faturimi, Inkasimi dhe Shpenzimet.....	60
Table 14 Të hyrat nga subvencionet ne emer te ujit te distribuar ne Veri.....	61
Table 15 Raporti Vjetor i Prokurimit.....	62

## **HYRJE**

Raportimi është obligim për kompaninë që del nga ligji Nr.03/L-087 për ndërmarrje publike. Ky raport pasqyron performancën e arritur të kompanisë në bazë të objektivave të caktuara paraprakisht të Kompanisë Rajonale e Ujësjellsit “Mitrovica” Sh.A. për periudhën Janar - Dhjetor të vitit 2018 duke u përqendruar në prioritetet e saj që janë furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijës dhe shërbime efikase për ujë dhe kanalizim.

Ky raport është i rëndësishëm në kuptimin e përmbushjes së objektivave dhe zhvillimeve të rëndësishme që kanë ndodhur në kompani qoftë në aspektin financiar po ashtu edhe në aspektin teknik, duke u fokusuar në përmbushjen e caqeve të përcaktuar me planin e biznesit përvitin 2018. Raporti që po paraqesim, synon jo vetëm të prezantoj aktivitetet e kryera gjatë periudhës së raportimit por i njëjti do të shërbej si udhëzues për vlerësimin e arritjeve apo ngecjeve të kompanisë në rrugën e saj drejt realizimit të performancës.

Raporti përmbanë të dhënat e kompanisë për sektorët e prodhimit, distribuimit, faturimit, inkasimit në njërën anë dhe shpenzimet e tërësishme të kompanisë në anën tjetër gjatë periudhës Janar – Dhjetor të vitit 2018 gjë e cila ilustronet përmes të dhënave të prezentuara në raport.

### **1. RAPORTI I KRYESUSIT TE BORDIT**

#### **1.1 AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES KRU “MITROVICA”**

Gjatë vitit 2018 Kompania ka vazhduar punën kontinuele duke u përpjekur që të përmbush misionin e saj e që është furnizimi i rregullt me sasi të mjaftushme të ujit dhe me cilësi konform standardeve për ujë të pishëm i të gjithë konsumatorve të kyqur në rrjetin e ujësjellsit e numri i tyre në fund të vitit **2018 ka qenë 31.775** .

Duke marr parasysh kapacitetin përpunues të fabrikave për trajtimin e ujit në Shipol dhe në Balince të cilat tani janë të mjaftushme dhe mund të plotësojnë nevojat e qytetareve të 5(pese) komunave menaxhmenti ka bërë përpjekje që furnizimi të jetë i balancuar nëpër komuna .

Me qëllim të zvoglimit të humbjeve teknike njeherit si dhe permisimit të kualitetit të ujit gjatë vitit 2018 Departamenti teknik do të vazhdon të marrë masa që të arrihet caku i zvoglimit të humbjeve duke kryer më shumë kontrolla në teren dhe të zbatohet vendimi për riparimin e rrjedhjeve në rrjetin e ujit të raportuara nga qytetaret, Institucionet dhe puntorëve të kompanisë, brenda 24 ore si dhe zbulimi i kyqjeve ilegale të cilët e shfrytzojnë ujin por nuk janë konsumator të KRU”Mitrovica”. Svida më e madhe për vitin 2020 do të jetë matja e ujit për të gjithë konsumatorët e KRU”Mitrovica”. është bërë rehabilitimi i sistemeve rurale të Ujësjellsit për

fshatrat e komunes së Mitrovices dhe Vushtrrisë në vlerë prej 790,410 euro nga Lux Dev\_it si dhe nga CDI vlera prej 448.507euro që ne total në rehabilitimin e rrjetit të ujit nga Lux-devi dhe CDI\_ja gjatë vitit 2018 janë investuar shuma prej 1.238.917euro. Perms projekteve te financuara nga Qeveria Zvicerane dhe e Kosoves e te implemtuara permes,CDI-Dorsch dhe Lux Dev-it jane instaluar ore te reja duke zavendesuar ato jo funksionale dhe duke zvogeluar konsumatoret paushall ne regjionin e Mitrovices si dhe u be hulumtimi dhe eliminimi i rrjedhjeve dhe zvogelimit te ujit te pafaturuar.Poashtu eshte bere dhe do te vazhdoje te trajnohet stafi i kompanise ne lemin e detektimit te rrjedhjeve duke I pajisur stafin me mjete dhe paisje me teknologji te avancuar.

Për të gjitha keto investime kompania nuk ka pas mundesi te participoj andaj falenderojme për përkrahje Qeverine e Zvicrres, Qeverin e Kosoves dhe Qeverin e Luksenburgut.

Perpos furnizimit me uje te pishem prej 24 oreshe qe ishte një e arritur shumë e madhe për qytetaret e regjionit, kompania është angazhuar ne mirmbajtjen e rrjetit te kanalizimit dhe vënjen nen kontroll te ujerave te zeza kurse ne Skenderaj keto ujra trajtohen ne impiantin per Trajtimin e ujerave te Zeza ne f.sh.Llaush.

Këto ne vija të trasha do te ishin aktivitetet e ndermarrura gjate vitit 2018 përpos atyre operative të perditshme.

Gjate vitit 2018, u kalua nga Inkasimi manual permes blokave dhe Inkasantave, ne Inkasimin permes pikave te shitjes dhe deri tani kemi 10 pik te shitjes ne regjion.

Gjithashtu edhe leximin manual dhe permes faturimit klasik e kemi kaluar ne nje forme me te avansuar ne leximin permes pajisjes PDA(aty per aty leximi dhe faturimi tek konsumatori) gje qe ndikon ne ngritjen e objektivitetit ne faturim dhe shkurtimin e kohes nga leximi deri ne dergimin e faturave.

Aktivitetet e cekura me larte do te kenë impakte ne vitet ne vijim dhe do te ndikojm ne përmisimin e indikatorëve operativ e financiar te cilet gjate vitit 2018 nuk kane qene te mire.

## **1.2 PASQYRA E PËRFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE**

Për te vlersuar përfomancen e nje kompanie publike eshte e nevojshme analiza e 4 grupeve te treguesve siq jane:

- Treguesit operativ dhe financiar,
- Knaqesia e konsumatorit,
- Avancimi i proceseve te brendshme dhe
- Mesimi dhe inovacioni.

Për dallim nga kompanit private ku qellimi eshte realizimi i profitit sa me te larte,te kompanit publike qellimi eshte përmbushja sa me e larte e nevojave dhe kerkesave te konsumatorit ose klientit duke shfrytzuar optimalisht kapacitetet si dhe duke optimizuar shpenzimet pra duke respektuar 3 tri parimet e njohura si 3E (ekonomizimi, eficenca , efikasiteti).

Ne këtë raport ne pika te shkurtera do te paraqesim performancen përmes disa tregusve operativ dhe financiar duke filluar nga :

**Prodhimi:** Gjatëperiudhës raportuese, sektori i prodhimit në tërsi ka funksionuar në suaza të normales dhe me kapacitete te plota.

Gjatë periudhës **Janar – Dhjetor** 2018 janë prodhuar gjithsejt 28,347.492 m<sup>3</sup> nga e cila sasi FTU në Shipol ka prodhuar 22,194.494 m<sup>3</sup> kurse FTU në Balinc 6,152.998 m<sup>3</sup>.

Sasia e përgjithëshme e prodhuar(28,347.492 m<sup>3</sup>) gjatë periudhës**Janar – Dhjetor** është shpërndar si vijon: Mitrovicës i janë shërndarë13,962.878 m<sup>3</sup>, Vushtrrisë – 6,152.998 m<sup>3</sup>, Skenderajt – 2,611.409 m<sup>3</sup> dhe Veriut 5,620.207 m<sup>3</sup>.

**Faturimi:** Gjatëperiudhës **Janar –Dhjetor 2018** sasia e tërësishme e ujit të faturuar ishte 11,553.470 m<sup>3</sup>. Nga kjo sasi Mitrovica ka 3,613.302 m<sup>3</sup>, Vushtrria ështëfaturuar me 1,705.090 m<sup>3</sup>, Skenderaj 614,871m<sup>3</sup> kurse Veriu me 5,620.207 m<sup>3</sup>

**Inkasimi:** Të hyrat e inkasuara gjatë periudhës **Janar – Dhjetor** 2018 në total arrinin shumën prej 3,175.526€. Njësia operative e Mitrovicës – 1,482.638 €, Vushtrria – 644,255 € dhe Skenderaj – 468,633€. Ndërsa subvencioni për Veri për vitin 2018 arrin shumën prej së 580,000 €:

**Shpenzimet:** Shpenzimet e teresishme për periudhën **Janar – Dhjetor** 2018 ishin 3,262.315 €. Kurse sipas njësive operative shpenzimet ishin se vijon: Mitrovica – 2,067635 €, Vushtrria 704,259 € dhe Skenderaj kishte 399,052 € shpenzime operative. Provizionimi i borxheve të këqija për të gjitha njësitë, gjatë vitit 2018 arrin shumën prej 91,369 €.

Gjatë vitit 2018, borxhi I krijuar arrinte shumën prej 2,843990 €, nga e cila shumë janë bërë pagesa në vlerë prej 1.555,560 €, ndërsa borxhi i mbetur arrin vlerën prej 1,288.430 € .

### 1.3 NGJARJET TE CILAT NDIKOJNE NË TË ARDHMEN E NDËRMARRJËS

Bazuar ne të dhenat e cekura me larte ne ndermarrje ndikim te veqant kishte leshimi ne pune i kapaciteteve te reja përpunuse te ujit me kapacitet 100% dhe marrja ne menaxhim qe po reflektonte ne domosdon e riparimit te rrjetit dhe sanimit, furnizimin me te mire dhe me cilesor te konsumatoreve dhe zvogelimin e reduktimeve. Keto po ndikojne me siguri ne vedisimin dhe rritjen e gadishmeris se konsumatoreve për pagesen e ujit te konsumuar, për qka nevojitet senzibilizim i tyre dhe kontakte sa me të rregullta të lexuesve te oreve dhe inkasantave sepse përpos që konsumatorit i ofrojme uje duhet te jemi shume afer tij për të realizuar inkasimin sa me të mire sepse rritja e komponenteve perpunuese do i rrit edhe shpenzimet operative ne vitet ne vijim.

Për përmbushjen e misionit Kompanisë i nevojitet përkrahja financuese nga donator e sidomos nga Qeveria e Kosoves të cilen e falenderojm për perkohjen e deritanishme.

Të dhenat me detale lidhur me punen e kompanis gjate vitit 2018 do ti paraqet Kryeshefi Ekzekutiv ndersa ne vazhdim ne këtë raport do te paraqes të dhenat për drejtoret jo ekzekutiv.

Bordi i Drejtoreve të KRU"Mitrovica"SHA ne Mitrovicë përbehej nga 6 drejtor jo-ekzekutiv dhe nga Kryeshefi dhe Zv.Kryeshefi Ekzekutiv.Ne Krye te BD eshte Kryesuesi I BD ndersa eshte emerue edhe Komisioni I Auditimit .

Ne vijim do te paraqes te dhenat per drejtoret e bordit te KRU Mitrovica:

#### ✓ **Bordi I DrejtoreveJoEkzekutiv**

<b>Nr.</b>	<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>Pozicita</b>	<b>Nr.Mbledhjeve prezent</b>	<b>Vlera e Kompensimit vjetor Brutto ne Eu</b>
1.	Blerim Gerxhaliu	Kryesues	14	5,400.00
2.	Mimoza Zeqiri	Anëtar	13	3,840.00
3.	Tefik Ujkani	Anëtar	13	3,840.00
4.	Zuke Beqiri	Anëtar	14	3,840.00
5.	Halil Thaqi	Anëtar	13	3,840.00
6.	Burhan Maxhuni	Anëtar	13	3,840.00
	<b>Gjithësejtë:</b>			<b>24,600.00</b>



## Komisioni I Auditimit

<b>Nr.</b>	<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Nr. Mbledhjeve prezent</b>	<b>Vlera e Kompensimit Brutto ne Eu.</b>
1.	Mimoza Zeqiri	Kryesues	13	1,320.00
2.	Tefik Ujkani	Anëtar	13	960.00
3.	Halil Thaqi	Anëtar	13	960.00
	<b>Gjithësejtë:</b>			<b>3,240.00</b>

Gjate vitit 2018 Bordi i drejtorëve ka mbajtur 14 takime si dhe Komisioni i Auditimit 13 takime.

Të gjitha takimet janë kryesuar nga Kryesuesi i Bordit dhe Kryetari i Komisionit të Auditimit të Brendshëm.

Bordi bazuar në Deklaratën e Politikës së Kompensimit të miratuar në fillim vit, në Maj miratoi Vendimin për shpërndarjen e bonuseve në lartësi 50% nga kompensimi vjetor ashtu si e parasheh ligji mbi Ndermarrje Publike, e që në vlerë arrin në 13,395.00 eu. Vendimi i lartecëkur mbi Bonuset, akoma nuk është implementuar por udhëhiqet në regjistrat kontable si obligim ndaj anëtarëve të Bordit të drejtorëve..

## 2. RAPORTI I KRYSHEFIT EKZEKUTIV

### 2.1 NGJARJET KRYSORE

Nga ngjarjet kryesore të cilat kanë veqar vitin 2018 janë të shumëta. Në këtë raport do të përmendim disa prej tyre:

- Perbushja e caqeve të projektuar me planin e biznesit për vitin 2018, (perkunder veshtersive te medha)
- Leshimi I plote I kapaciteteve te Impiantit për trajtimin e ujit në Balincë të Vushtrris me kapacitet prej 350 l/sdonacion nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që po plotësohen 100% të gjitha nevojat për ujë të pijeshem per Komunen e Vushtrrise.
- Ka vazhduar implementimi i projektit për zvoglimin e humbjeve që financohet nga Qeveria e Luksemburgut.
- Eshte avansua forma e Inkasimit duke kaluar nga Inkasimi perms bllokave manual ne lkasimin perms 10 pikave te shitjes.
- Eshte Avansua sistemi I faturimit , duke kaluar 90% nga Leximi manual dhe dergimi I fatures pas 15 ditesh, ne leximin te konsumatori dhe leshimin e fatures ne te njejten kohe kur edhe lexohet konsumi permes Implementimit te projektit per Pajisje me PDA.
- Është vazhduar me projektet e ndertimit te sistemeve ne zonat rurale te financuata nga faza e VI e projektitet te Qeverise se Kosoves dhe Qeverise se Zvicres;

Në vazhdim të ketij raporti do e përshkruajm punën në menyre detale të Kompania Rajonale Ujësjellësit “Mitrovica” Sh.a. gjatë vitit 2018.

## 2.2 PASQYRIMI I PERFORMANCËS DHE REZULTATET E INDIKATORËVE KYQ TË PERFORMANCËS

Të gjitha orientimet dhe masat e ndërmarruna të KUR “Mitrovica” sh.a. brenda ketij viti mund të përmblihen si aktiviteteve të domosdoshme me qëllim të rritjes përkatësisht të përmirësimit të një numri të treguesve të performancës.

Kjo do të thot se kompania me të gjitha resurset që ka pas në disponim ka bërë përpjekjet e saja që të përmirësoj indikatorët kryesor të performancës si:

### 2.2.1 RAPORTI I SHËRBIMIT KOMERCIAL

#### Gjendja e konsumatorëve

Nurmi I konsumatorëve të kompanisë gjatë vitit 2018 krahasuar me vitin paraprak ka pësuar një rritje prej 1,846 konsumatorëve të rinjë. Kjo gjendje mund të shihet ne tabelën ne vijim.

Table 1 Rritja e numrit të Konsumatorëve – krahasimi 2018/2017

Viti	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2017	27,518	27,819	28,142	28,441	28,725	29,016	29,247	29,521	29,591	29,707	29,818	29,929
2018	30,001	29,854	30,167	30,278	30,363	30,461	30,666	30,584	31,061	31,478	31,452	31,775

Ndërsa sa I përket numrit të konsumatorëve sipas kategorive të konsumatorëve, tabela në vazhdim jep sqarim të detajuar mbi gjendjen e konsumatorëve gjat periudhën Janar – dhjetor 2018. Në tabel figurojnë edhe konsumatorët pasiv .

Table 2 Konsumatorë e rexhistruar sipas muajve

		NUMRI I KONSUMATOREVE TE REGJISTRUAR JANAR - DHJETOR 2018											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
<b>KATEGORIA</b>	numër	30.001	29.854	30.167	30.278	30.363	30.461	30.666	30.854	31.061	31.478	31.452	31.775
Konsumatorët Shtëpiak	numër	27.177	26.993	27.287	27.390	27.466	27.566	27.756	27.938	28.144	28.554	28.533	28.815
Konsumatorët Komerrial-Industrial	numër	2.517	2.551	2.570	2.577	2.586	2.584	2.596	2.602	2.601	2.611	2.597	2.630
Konsumatorët Institucional	numër	307	310	310	311	311	311	314	314	316	313	322	330
		NUMRI I KONSUMATOREVE QE FATUROHEN SIPAS LEXIMIT TE UJEMATESVE											
<b>KATEGORIA</b>	numër	21.251	21.403	21.715	21.915	22.083	22.315	22.608	22.849	23.050	23.411	23.787	24.179
Konsumatorët Shtëpiak	numër	18.834	18.966	19.248	19.436	19.586	19.808	20.088	20.319	20.508	20.862	21.223	21.576
Konsumatorët Komerrial-Industrial	numër	2.138	2.155	2.185	2.197	2.215	2.225	2.236	2.246	2.256	2.266	2.281	2.312
Konsumatorët Institucional	numër	279	282	282	282	282	282	284	284	286	283	283	291
		NUMRI I KONSUMATOREVE QE FATUROHEN NE BAZE PAUSHALE											
<b>KATEGORIA</b>	numër	8.750	8.451	8.452	8.363	8.280	8.146	8.058	8.005	8.011	8.067	7.665	7.596
Konsumatorët Shtëpiak	numër	8.343	8.027	8.039	7.954	7.880	7.758	7.668	7.619	7.636	7.692	7.310	7.239
Konsumatorët Komerrial-Industrial	numër	379	396	385	380	371	359	360	356	345	345	316	318
Konsumatorët Institucional	numër	28	28	28	29	29	29	30	30	30	30	39	39
		NUMRI I KONSUMATOREVE TE CILET PAGUAJN FATURAT NE BAZE MUJORE											
<b>KATEGORIA</b>	numër	6059	6103	7054	6555	6800	6884	7366	7645	6943	7732	7250	7932
Konsumatorët Shtëpiak	numër	5499	5.372	6.289	5.853	6057	6.233	6.656	6.963	6.292	6.906	5.605	7.179
Konsumatorët Komerrial-Industrial	numër	495	617	647	577	607	547	587	589	565	678	565	605
Konsumatorët Institucional	numër	65	114	118	125	136	104	123	93	86	148	86	148

Table 3 Performanca operative sipas njësive, kategorive dhe viteve krahasuese

**PERFORMANCA SIPAS NJESIVE KATEGORIVE DHE VITEVE KRAHASUESE 2018/2017**

		MITROVICE			VUSHTRRI			SKENDERAJ			KRU Mitrovica		
Nr .	N r.	KATEGORIA	2017	2018	2018/2017	2017	2018	2018/2017	2017	2018	2018/2017	2017	2018
0	0	1	2	3	4=(3/2)	5	6	7=(6/5)	8	9	10=(9/8)	11	12
1	1	Amvisni	839.293	969.556	116%	314.405	440.354	140%	153.578	181.287	118%	1.307.275	1.591.197
2	2	Biznes	183.454	208.706	114%	24.737	46.337	187%	31.243	30.171	97%	239.434	285.214
3	3	Ekonomi	114.227	117.545	103%	8.894	6.422	72%	23.450	26.623	114%	146.571	150.590
4	4	Institucionet	148.434	144.282	97%	71.678	88.739	124%	29.941	225.027	752%	250.051	458.048
5	5	Ndërkombtaret	12.122	11.393	94%		54.382	0				12.123	65.775
<b>TOTALI 1</b>		<b>TOTALI 1</b>	<b>1.297.530</b>	<b>1.451.482</b>	<b>112%</b>	<b>419.714</b>	<b>636.233</b>	<b>152%</b>	<b>238.212</b>	<b>463.109</b>	<b>194%</b>	<b>1.955.454</b>	<b>2.550.824</b>
6	6	Sherbimet me 0%				-				-			
7	7	Sherbimet me 8%				-	-			-			
8	8	Sherbimet me 18%	15.460	31.157	202%	19.594	8.022	41%	6.798	5.524	81%	41.852	44.702
<b>Total Sherbimet</b>		<b>Total Sherbimet</b>	15.460	31.157	2022%	19.594	8.022	41%	6.798	5.524	81%	41.852	44.702
<b>TOTALI 2</b>		<b>TOTALI 2</b>	<b>1.312.990</b>	<b>1.482.639</b>	<b>113%</b>	<b>439.308</b>	<b>644.255</b>	<b>147%</b>	<b>245.010</b>	<b>468.633</b>	<b>191%</b>	<b>1.997.306</b>	<b>2.595.526</b>
9	9	Subvencioni	987.201	580.000	58.75%							987.201	580.000
<b>TOTALI 3</b>		<b>TOTALI 3</b>	<b>2.300.191</b>	<b>2.062.639</b>	<b>90%</b>	<b>439.308</b>	<b>644.255</b>	<b>147%</b>	<b>245.010</b>	<b>468.633</b>	<b>191%</b>	<b>2.984.507</b>	<b>3.175.526</b>

Në bazë të indikatorëve të paraqitur në tabelë, kategoritë të cilat ka pasur rritje ne inkasim janë: Amvisëria 22%, Biznesi 19%, Ekonomi 3%, Institucionet 83%, Nderkombetar 543% si dhe Sherbime 7%. Total kemi një rritje të performancës së përgjithëshme të inkasimit 29.95 % pa inkasimin per veri permes subvenciovebe, ndersa se bashku me veri, rritja arrin ne 6.4 %. Per shkak se subvencioni I vitit 2018 ishte me I vogel 407.201 ose 41.25%.

Table 4 Performanca e Njësive Operative për vitet 2017 dhe 2018 – Inkasimi ndaj Faturimit

PERFORMANCA SIPAS NJESIVE					
2018					
NJËSIA	Fat m3	Çmimi/m3 (=0,56€)	Fat €	Inkasiml	Performanca
Mitrovicë	3,613.302	0.62	2,231,048	1,482,639	66.45%
Vushtrri	1,705.090	0.56	949,565	644,255	67.85%
Skenderaj	614,871	0.60	371,716	468,633	126.1%
<b>Gjithësejt</b>	5,933.263	0.60	3,552,329	2,595,527	73.07%

2017					
NJËSIA	Fat m3	Çmimi/m3 (=0,57€)	Fat €	Inkasiml	Performanca
Mitrovicë	3.584.157	0.57	2.037.795	1,215,649	59.5%
Vushtrri	1.665.826	0.57	876.467	407,114	46.4%
Skenderaj	590.908	0.57	328.499	226,321	68.9%
<b>Gjithësejt</b>	5.840.892	0.57	3.242.762	1,849,084	57%

Nga tabel sipër shihet performance vjetore e Inkasimin ne raport me faturimin te Njësive Operative; Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj pa veriun dhe krahasimit ndërmjet vitit 2018 me atë paraprak 2017:

- Mitrovica gjatë vitit 2018 ka pasur një performancë ne ngritje për 6.95 % krahasuar me vitin paraprak.
- Vushtrria gjatë vitit 2018 ka pësuar ngritje të performancës për 21.45 % krahasuar me vitin paraprak.
- Skenderaj gjatë vitit 2018 ka pesuar ngritje të performancës për 57.2 %.

Pra sikurse shihet nga të dhënat e lartëcekura, performance e të gjitha njësive ka pasur ngritje në krahasimi me vitin 2017 per 16.07%.

Table 5 Numri I konsumatoreve ne baze te matjes dhe pagesat sipas kategorive

Kategori a	ME/P A U.M.	Janar		Shkurt		Mars		Prill		Maj		Qershor		Korrik		Gusht		Shtator		Tetor		Nëntor		Dhjetor	
		Nr. Kons	Pag esa	Nr. Kons	Pages a	Nr. Kons	Pag esa	Nr. Kons	Pag esa	Nr. Kons	Pag esa	Nr. Kons	Pag esa	Nr.K ons	Page sa	Nr.K ons	Page sa		Page sa		Page sa		Page sa		Page sa
Amvisni	Me um.	18834	5500	18966	5371	19248	6287	19436	5852	19586	6055	19808	6233	20088	6655	20319	6964	20508	6299	20862	6906	21223	6601	21576	7182
	Pa um.	8110		7796		7807		7717		7645		7513		7411		7360		7362		7406		7310		7239	
Kom.In dustrial	Me um.	2138	463	2155	570	2185	602	2197	530	2215	562	2225	506	2236	546	2246	554	2256	537	2266	635	2281	528	2312	558
	Pa um.	351		348		358		352		342		332		334		330		324		318		316		318	
Instytucjo nal	Me um.	279	98	282	162	282	167	281	176	281	184	281	147	282	167	282	131	284	131	283	194	283	127	291	197
	Pa um.	25		25		25		26		26		26		27		27		27		27		39		39	
Total		29737	6061	29572	6103	29905	7056	30009	6558	30095	6801	30185	6886	30378	7368	30564	7649	30761	6967	31162	7735	31452	7256	31775	7937

Tabela e lartependur, paraqet numrin e konsumatoreve qe paguajn ne baza mujore sipas kategorive dhe muajve, dhe shihet se ky numer ka rritje tek kategoria e Amvisnise nga 5500 konsumator ne janar ne 7182 konsumatore ne dhjetor qe d.m.th per 1682 konsumatore, kjo rritje ka vazhdu edhe tek institucionet por lene per deshiruar rritja tek bizneset.

Ne total rritja e konsumatoreve qe paguajn faturat rregullisht nga janari ne dhjetor ka arrit ne 1876 konsumatore, me gjithesejte ne dhjetor prej 7937 konsumator apo vetem 24.98% nga konsumatorët e teresishem.

### 3. RAPORT I DEPARTAMENTIT TEKNIK

#### Departamenti Teknik – Janar - Dhjetor 2018

---

Departamenti teknik gjate periudhes janar – Dhjetor 2018 , ka qene aktiv ne permbushjen e detyrave si ne prodhim , furnizim me uje,mirembajtje te objekteve ,mirembajtje te rrjetit te ujit , mirembajtje te rrjetit te kanalizimit , mirembajtje te ITUve ,ITUZ dhe stacioneve te pompave.

Furnizimi me uje I ITU ne shipol dhe Balince behet nga liqeni I Pridvorices,permese kanalit te ujitjese Iber ,ku behet edhe kaptimi I ujit te pa perpunuar nga fshati Lushte per ITU Shipol Mitrovice she ne Balince per ITU e Vushtrrise.Sipas analizave laboratorike te ujit te paperpunuar,parametrat ne ujin e pa perpunuar jane : trubullira,vlera e larte e karbonit organic,koncentrimi I nitrateve dhe baktereve koliforme.keto vlera tregojne qarte se uji I pa perpunuar nuk eshte I gatshem per tu konsumuar.ITU ne Balince ka furnizuar qytetinn e Vushtrrise me uje se bashku me fshaterat qe kane rrjet te ujit aktiv ne kete komune,ndersaITU Shipol ka furnizuar qytetet Mitrovice,Skendraj,Mitrovice Veriore dhe Zveçan.

Gjate muajt te vitit 2018 , ITU ne Shipol ka prodhuar 22194494 m3 dhe ITU Balince 6152998 m3 ,qe ne total kane trajtuar dhe distribuar 28347492 m3 siç shihet ne tabelën 1.

Nëse krahasohet prodhimi ne total për një vite kalendarik , del se kemi rrite prodhimin për 513537 m3 ose e shprehur ne përqindje , për 0.18 % me shume se sa për vitit 2017 siq shihet ne tabelin 2 . Kjo rritje e kapacitetit është ne kundërshtim me caqet qe kompania i ka parapare mbi zvogëlimin e humbjeve fizike dhe komerciale , por furnizimi për komunën e Vushtrrisë dhe Skenderajt ka ndikuar qe kemi ma tepër uje te prodhuara se ne vitin e kaluar. Furnizimi I konsumatoreve gjate tere vitit ka qene pa nderprer , me nje shtypje minimum 2-2.5 bare qe eshte sukses I KRU,„Mitrovica” . Gjate tere vitit konsumatoret e Komunes se Vushtrrise jane furnizuar me uje vetem nga ITU Balince por ne kohen e veres kemi punuar me orar te zgjatur 15 ore ne dite qe ka ndikuar direct ne ngritje te prodhimit dhe humbjet kane qene ma te larta se ne vitin paraprak per kete periudhe.

Departamenti teknik do te vazhdon te merr masa qe te arrihet caku i zvogëlimit te humbjeve duke kryer me shume kontrolla ne teren dhe te zbatohet vendimi per riparimin e rrjedhjeve ne rrjetit e ujit te raportuara nga qytetaret ,instutucionet dhe puntoreve te kompanise , brenda 24 ore dhe zbulimin e kyqjeve ilegale te cilet e shfrytezoin ujin por nuk jane konsumatore te KRU,„Mitrovica”.



**Sifida me e madhe e vitit 2019 do te jete matja e ujit per te gjithe konsumatoret e KRU,,Mitrovica''**

Tabela1 Prodhimi i ujit nga ITU te

Uji i prodhuar - ITU	Shipol m3	l/s	Balince m3	l/s	Totali m3	l/s
Janar	1897378	708.40	412.520	154,02	2309898	862.42
Shkurt	1772404	732.64	364810	150.79	2137214	883.43
Mars	1823879	681	480716	179.47	2304595	860.47
Prill	1769812	683	511548	198	2281360	883
Maj	1912645	714	541069	202	2453714	916
Qershor	1806493	697	568322	219	2374815	916
Korrik	1895285	707	582883	217.6	2478168	925
Gusht	1986173	741	641042	239	2627215	980
Shtator	1883967	726	509757	196	2393724	922
Tetor	1816208	678	515152	192.33	2331360	870.3
Nentor	1785369	688	514263	198.4	2299632	887
Dhjetor	1844881	689	510916	190.7	2355797	879.7
Totali	22194494		6152998		28347492	

Tabela numër 2 krahasimi i furnizimit nga ITU te

Uji i prodhuar – ITUte	Viti 2017 m3	Viti 2018 m3	Diferenca m3
Janar	2486385	2309898	176487
Shkurt	2155165	2137214	17951
Mars	2312682	2304073	8609
Prill	2221630	2281360	- 59730
Maj	2264845	2453714	- 188869
Qershor	2320400	2374815	- 54415
Korrik	2537285	2478168	59117
Gusht	2488834	2627215	- 138381
Shtator	2390999	2393724	-2725
Tetor	2338678	2331360	7318
Nentor	2127544	2299632	-172088
Dhjetor	2189508	2355797	-166289
Totali	27833955	28347492	-513537

**Kualiteti i ujit** - Gjate muajit dhjetor janë marr 3212 mostra dhe janë kryer 36748 analiza fiziko – kimike ne laboratorët e impianteve ,prej te cilave 2178 mostra ne ITU Shipol dhe janë kryer 22704 analiza fiziko kimike ne Shipol, ndërsa 1034 mostra ne Balince, ku janë kryer 14044 analiza fiziko – kimike, te cilat kane rezultuar ne suaza normale te standardeve për ujë te pijes.

Analizat fiziko - kimike te kryera ne laboratorët e impianteve janë paraqitur ne tabelën tre dëshmon për kualitet te larte te ujit te prodhuar. Ky kualitet dëshmohet edhe me analizat e kryera nga IKSH ne Kosove dega ne Mitrovice ,te cilat përputhen me vlerat e gjetura ne ujin e pa përpunuar dhe te përpunuar ne laboratorët tona .

Ne labororet e ITUve te KRU,,Mitrovica” behen analizat fiziko kimike te ujit te pa trajtuar dhe ujit te trajtuar por jo edhe ato bakterologjike.Keto analiza behen çdo 4 ore,qe do te thote 6 here Brenda 24 oreve ne Shipol ndeersa ne Balince vetem dy deri ne tri here ne dite. Ne keto analiza perfshihen : Era,shija,trubullira,ngjyra,shkalla Co-Pt ,vlera e pH,

Tablela 3 Analiza fiziko –kimike ne laboratorin ITU Shipol - Balince

Parametrat	Nr i pergjithe shem i testeve	% negat iv	% Pozitiv	ITU  Vlera mesatare	Vlera referent standarde
Klori i mbetur	0	0	100	0.43 mg/l	0.0-0.5
Turbullira	0	0	100	0.15 NTU	1.2-2.4
Aroma	0	0	100	Pa	Pa
Shija	0	0	100	Pa	Pa
PH	0	0	100	7.7	6.8-8.5
Temperatura	0	0	100	6.5 C	8-12
Nitritet	0	0	100	gjurme mg/l	0.005
Amoniaku	0	0	100	ska shenje	mg/l
Nitratet	0	0	100	0.0015 mg/l	10
Perqeshmeria	0	0	100	203 ms/cm	1500
Sulfatet	0	0	100	00 mg/SO4	200
Shpenzimi i KMnO4	0	0	100	4.0 mg/l	8-12
Hekuri	0	0	100	≤0.1 mg/l	0.3
Alumini	0	0	100	mg/l	
Mangani	0	0	100	gjurme mg/l	0.05

#### Analizat fiziko – kimike dhe bakterologjike.

Nga IKSH ne Mitrovice raportohet se janë marre dhe analizuar 384 mostra te ujit te trajtuar. Uji i trajtuar e ne ITU Shipol (2) dy mostra ,kurse ne ITU Balince vetëm (1) një mostër. Numri i mostrave te marruar neper Komuna është si ne tabelën 5.

Tabela 4

Komuna	Mostrat ne total	Kimike	Bakteriologjike	I përgjigjet	Nuk i përgjigjet
Mitrovice	192	96	96	192	0
Vushtrri	96	48	48	96	0
Skenderaj	96	48	48	96	0

Te gjitha mostrat qe merren nga ky institut ,kontrollohet uji i trajtuar ne Shipol , Balince dhe ne vende te ndryshme te rrjetit qe furnizimohen konsumatorët me ujë te pijshëm nga KRU „Mitrovica” . Ky monitorim do te vazhdon edhe vitin 2019 duke pas parasysh se ne akoma nuk jemi te gatshem per akreditim.

**Kemikatet - Gjate vitit 2018,** për trajtim te ujit te pa përpunuar është përdore si kaugulant alumin sulfati ne Balince , kloruri ferik ne ITU e Shipolit, ndërsa si dezinfektues klori i gazet ne te dy ITU \_te, ndersa ozone eshte perdorur vetem ne ITU ne Shipol. Nga tabela 5 shihet se gjate muajit keti viti kalendarik , për trajtim te ujit te pa përpunuar janë shpenzuar 32731 kg alumin sulfat –I cili kryesisht perdoret ne ITU ne Balince dhe vetem ne raste te rralla ne ITU ne Shipol, 128650 kg klorur ferik , polielektrolit 215 kg dhe si dezinfektues 33268 kg klor i gazet .

**Spektori i elektro – makinerisë** gjate vitit 2018 ka kryer aktivitetet mbi mirëmbajtjen e ITU\_ve dhe stacioneve te pompimit sipas planit dhe nevojave te intervenimit ne stacionet e pompave dhe ITUve. Gjate tere vitit ne pergjithesi te gjitha ITUte dhe stacionet e pompave kane funksionuar mire dhe nuk ka pas ndërprerje me furnizim te konsumatoreve me ujë te pijshëm. Si pasoj e probleme ne trajtim por vetem ne raste te nderprejeve te rrymes ose kerkesave nga njesit operative per ndonjin riparim te rrjetit ne vijat magjistrale

Tabela 5 Sasia e kemikaleve për gjate muajve

Kemikalet/ Muaj	Shipol	Balinc	Shipol	Balinc	Shipol	Balinc	Shipol
	Alumin sulfati Kg		Polielektroliti Kg		Klori gaz Kg		Klorurife rik - kg
Janar	0	1260	0	0	1467	674	9250
Shkurt	0	2099	0	10	1476	565	20000
Mars	0	3548	0	10	1500	633	16000
Prill	4000	2079	0	0	1400	796	11300
Maj	6000	2279	0	5	1850	847	4500
Qershor	0	2374	0	5	1450	892	11000
Korrik	0	1639	0	10	1870	820	11500
Gusht	0	1574	0	5	2180	928	14500
Shtator	0	1202	0	5	2900	795	13500
Tetor	0	1856	0	5	3100	771	9300
Nentor	0	1561	0	5	3000	839	7500
Dhjetor	0	1342	150	5	2557	769	7800
Totali	10000	22731	150	65	24759	8509	128650
Gjithesej	32731		215		33268		128650

**Stacioni i pompave Lushte** – i cili është stacioni kryesor i furnizimit me ujë për Rajonin e Mitrovicës ,qe furnizon Komunën e Mitrovicës,Skenderajt dhe pjesën Veriore ,ka punuar me kapacitet te plot ,dhe sipas nevojës ekipet kane mirembajtur paisjet elektro maqinerike.

Stacioni i pomapve Reke – I cili është stacioni kryesor për furnizimin e qytetës Tuneli i Pare , Staritergut dhe fshatrave Rahove e Reke. Ky stacion gjatë gjithë vitit ka qenë në gjendje të mirë edhe pse është veçuar me një pompë që është investuar vitin 2017 .

Stacioni Pomave Tuneli i Pare dhe Trepçës, gjatë vitit 2018 kanë pasur një gjendje të stabilizuar të punës dhe nuk kanë pasur defekte të mëdha në përjashtim të mungesës së tensionit të rrymës në stacionin e Trepçës me çka po rrezikohen pompat me furnizim jo kualitativ nga KEDS.

**Stacioni i pompave Koshtove** – Ky stacion i pompave është pranuar këto vite dhe është filluar me furnizimin e konsumatorëve , por gjendja e stacionit të pompave në këto fshata dhe rezervari shpërndarës nuk është mirë dhe duhet të ndërhyrë shumë shpejt në riparimin e këtij stacioni.

**Stacioni i pompave Verrnice** - ky stacion është në gjendje të mirë dhe tani ,qytetarët furnizohen me ujë por problem , por ka mbetur shpronësimi i tokës të cilën akoma komuna nuk e ka kryer procedurën sipas kërkesës së ujësjellësi .

**Stacioni i pompave Ternavce për Prekaz** – është duke funksionuar mirë dhe në të njëjtën kohë po furnizohet edhe Ternavci dhe Klina e Eperme Lagjja Tahiri . Furnizimi me rrymë është stabil dhe furnizimi me ujë nuk ka pasur ndonjë mungesë në tri fshatrat që furnizojnë ky stacion.

**Stacioni i pompave Qaber** – po punon me kapacitet të plotë dhe pa ndonjë problem në mirëmbajtje. Këtë stacion e mirëmban KRU „Mitrovica“ ndërsa të gjitha investimet kryhen nga zyra lokale. Është përshirur kërkesë për të shqyrtuar mundësinë që konsumatorët të cilët furnizohen nga ky **stacion që gjendet në pjesën veriore , të faturohen vetëm me tarifë fikse .**

**ITUZ në Skenderaj** - gjatë vitit 2018 , në ITUZ Skenderaj janë trajtuar 734421 m<sup>3</sup> ujë të zeza dhe gjatë tërë vitit nuk ka pasur probleme teknike dhe impianti ka punë me kapacitet të plotë përveç në ditët me të reshura atmosferike , kur ka pasur ardhje të ujit atmosferik , në këto raste ujë nuk është trajtuar. Në laboratorin e impiantit gjatë vitit janë marrë 48 mostra dhe janë analizuar 384 parametra nga secila mostrë dhe ujë i trajtuar i plotëson kriteret për tu derdhur në lumë. Duhet të ceket se kemi akoma nuk kemi leje nga ministria e ambientit për derdhjen e ujërave të zeza në lumenjtë e Kosovës edhe pse kjo ka ardhur si pasojë e mungesës së dokumentave për impiantin.

**Raport i Njësive Operative** - gjatë vitit 2018, tri njësitë operative janë furnizuar me ujë, 22719445 m<sup>3</sup> ndërsa për komunat veriore, Mitrovica e Veri ,Zveçani ,Gojbule së bashku me fshatin Suhodoll është furnizuar me 5628047 m<sup>3</sup> ,siç shihet në tabelën numër (6) gjashtë.

Duhet të theksohet se pesë komunat, Mitrovica Jugore , Mitrovica Veriore , ,Skenderaj , Zveçan dhe Vushtrri janë furnizuar pa ndërpre me ujë.

Rritja e prodhimit gjatë këtij viti nuk është e madhe në krahasim me vitin para-prak nuk është e madhe e cila ka ardhur si pasojë e furnizimit më të mirë të Komunës së Vushtrrit dhe Skenderajt.

Tabela 7 Humbjet teknike

Humbjet jane te medha por nuk mund te raportohet si humbje fizike ose teknike te ujit , por kjo kryesisht del se është ujë i konsumuar po i pa faturuar. Gjate vitit 2018 kemi arritur ti zvogloim humbjet edhe pa veriun por edhe me veriun . Ky zvoglrim eshte arritur duke i kontrolluar zonat te cilat po shkaktoin humbjet me te medha por te cilat nuk fakturohen (siq eshte rasti i fabrikeve qe kane perodore uje nga distribuimi por nuk jane future ne faturim , ndersa eshte numruar si humbje fizike,pastaj objektet administrative dhe stacionet e pompave , krojet publike ,xhamiat ,vecet publike, si dhe disa ndertesa te institucioneve qe nuk jane perfshire ne ujematesat perkates e qeui nuk eshte faturar por eshte numruar si humbje teknike sidomos rasti lagjeve me minoritete ku qasja tek ta eshte shume pak e vogel ose aspak lagjja e Romev dhe eserbeve te Gojbules ku ata furnizohen me 3% te humbjes vjetore ,dhe kjo eshte numruar si humbje fizike e jo si uje i konsumuar.

Tabela 6 Shpërndarja e distribuimit për katër njësit operative

Qyteti	Mitrovica	Vushtrri	Skenderaj	Mitrovica	Totali
Muaj	Jugore			Veriore	
Janar	1266789	412520	218600	411989	2309898
Shkurt	1174754	364810	209400	388250	2137214
Mars	1167707	480716	230000	426172	2304595
Prill	1181691	511548	197777	390344	2281360
Maj	1253732	541069	226536	432377	2453714
Qershor	1244824	568322	199949	361720	2374815
Korrik	1196000	582883	219552	479733	2478168
Gusht	1237539	641042	241192	507442	2627215
Shtator	1141480	509757	227200	515287	2393724
Tetor	1003443	515152	222063	590702	2331360
Nentor	1055253	505763	207700	530916	2299632
Dhjetor	1039666	510916	212100	593115	2355797
Totali	13962878	6144498	2612069	5628047	28347492

Njesite operative gjate vitit 2019 do te vendosin matjet e ujit per objektet administrative te ujesjellesit , krojeve dhe wc publike e qe do te ndikon direk ne zvoglimin e humbjeve fizike.

Nje dukuri e cila eshte shqetesuese per kompanin eshte faturimi I cili gjate tere vitit nuk eshte ne perputhje me numrin e konsumatoreve dhe prodhimin vjetore qe e kemi. Mos faturimi del qe humbjet jane ma te larta neper njësi operative Mitrovicë, Skenderaj e sidomos Vushtrri ,duke pas parasysh furnizimins e ujit i cili është distribuar gjate vitit ka qene i larte,

**Njësite Operative Mitrovicë ,Vushtrri dhe Skenderaj** - gjate vitit 2018, kane pranuar 4167 kërkesa (shih tabelen 7), prej te cilave 1144 kërkesa kane qene rrjedhje te mëdha , te mesme dhe te vogla ,ndërsa kërkesat tjera ne mirëmbajtje te rrjetit te kanalizim ,montim ujëmatësve,riparim te ujëmatësve,kyçje te reja ,hulumtim rrjetit për shkak te rrjedhjeve te pa dukshme dhe riparim te valvuleve.

Tabela 7 Parametrat e mirëmbajtjeve te rrjetit te ujit dhe kanalizimit

Nr	Njesit Operative	Njesia	Total
	<b>Parametrat Rrjeti i ujit</b>		
2	Nr.i kerkesave	nr./cop	4167
3	Nr.i kerkesave të realizuara	nr./cop	4043
4	Nr.i kerkesave të porealizuara	nr./cop	127
5	Numri i prishjeve në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm	nr./cop	965
6	Numri i prishjeve të riparuar në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm	nr./cop	873
7	Numri i prishjeve në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm	nr./cop	179
8	Numri i prishjeve të riparuar në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm	nr./cop	176
9	Gjatsia e rrjetit të ujësjellësit	M	856076
10	Kyçje të reja në ujësjellës	nr.	861
11	Montimi i ujëmatësve	nr.	1379
12	Riparimi i ujëmatësve	nr.	926
13	Kyçje ilegale	Nr.	405
	<b>Rrjeti I kanalizimit</b>		
1	Kerkesat		1148
2	Kerkesat e realizuara		1108
3	Kerkesat e pa realizuara		40
4	Nr. i përgjithshëm i pusetave të kanalizimit	nr.	3789
5	Nr. i pusetave të kanalizimit të inspektuara	nr.	961
6	Gjatsia e rrjetit të kanalizimit të pastruar	M	46766
7	Numri i bllokimeve në	nr./cope	1035



	kanalizim		
8	Gjatësia e rrjetit të kanalizimit	M	240220
9	Kyçje të reja në kanalizim	nr./cop	470

Njësit Operative , gjate keti viti kane qene shume aktive ne riparime te rrjetit te ujit , deblokimeve te kanalizimit ,motim te ujematesve edhe pse gjate kesaj kohe ka qene duke operuar edhe donatoret ne montim te ujematesve .

Spektori i mirmbajtjese se automjeteve ka kryer nje varg aktivitetesh te cilat kane ndikuar ne kontrollin dhe funksionalizimin e automjeteve ne menyre qe aktiviteti I njesive operative te jete ne nivel. Ne shume raste kane vepruar qe vete I kane riparuar autojetet dhe kompania ka ka kursyer mjete financiare

Mirëmbajtjen e rrjetit te kanalizimit ka kryer 1148 kerkesa te ndryshme ne rrjetin e kanalizimit ne te tri njesit edhe përkundër mungesës se mjeteve te punes e sidomos njesia e Vushtrrise te ciles I mungon atocisterna me presion ..

## **4. RAPORTI I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV**

### **PREJ 01.01. 2018 e gjerë me 31.12.2018.**

Departamenti e Administratës gjatë kësaj periudhe ka bërë përgatitjen e Raporteve dhe Informatave nga veprimtaria e Shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë Departament.

-Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur të gjithë procesverbalet dhe Vendimet e dalura nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe janë dërguar anëtarëve të Bordit dhe KAB-së si dhe NJPMNP;

-Shërbimi juridik ka përgatitur të gjitha llojet e Kontratave të Kompanisë si dhe palëve të treta të cilat kanë të bëjnë me veprimtarin e Kompanisë;

-Shërbimi juridik bënë përgatitjen si dhe lëshimin e të gjitha llojeve të Aktvendimeve, Autorizimeve, dhe Vërtetimeve nga fusha e marrëdhënies së punës etj;

-Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur dhe shpallur në shtypin ditor Konkursset për vendet e parapara të punës.

-Janë përgatitur dhe lëshuar Aktvendimet për pushime vjetore sipas kërkesës me shkrim të të punësuarve dhe aprovimit apo pëlqimi nga udhëheqësit e tyre;

Gjate kësaj periudhe 10 persona janë pensionuar dhe 7 i është ndërpre kontrata e punës në KRUM, 2 nga ta ju ka ndërpre Kontrata nga BtD ndërsa 5 te tjerë kanë qen ne pushim pa pagesë por ne kohen kur është dashur te lajmërohen ne pune s'janë lajmëruar një nga ta ka filluar punën ne një shkolle ndërsa 4 janë jashtë shteti.

Pjesëmarrja ne Komisioni Këshillues te Konsumatorëve i cili mbahet çdo muaj nga një dite.

### **Kontestet Gjyqësore për këtë periudhë 01.01.2018 - 31.12.2018 janë:**

Shqyrtim për veturën e djegur Hyundai Santa Fe vlera 6,000.00 € e cila shtyhet për date 03.05.2018 ne mungesë te gjyqtarit, dhe jemi ne pritje te Vendimit nga Prokuroria Themelore ne Mitrovice. Padi për kompensim demi si pale e dëmtuar me rastin e Depos Lënda P.nr 121/15 vlera e Kontestit sipas Ekspertizës 69,757.73 € te cilin e kemi dërguar ne kontest civil pas lirimit nga aktakuza te dyshuarve për rastin ne fjale, Përgjigje ne Padi për lenden 144/17 i cili kërkon te kompensohet demi ne vlerën prej 32.000 € për dëmtim te shtëpisë nga rrjedha e Ujite, padi për lirim banese ne Gjykatën Themelore Prishtine dep Administrative.

